



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 2 maj 2024
Nr. ref.: MM 2427/24

MENDIM MOSPAJTUES

i gjyqtarit

RADOMIR LABAN

në

rastin nr. KI115/23

Parashtrues

Bratislav Nikolić

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [PN1. nr. 422/2023], të 28 prillit 2023, të Gjykatës së Apelit të Kosovës

Duke shprehur që në fillim respektin tim ndaj mendimit të shumicës së gjyqtarëve në këtë rast, të cilët me shumicë votash konstatuan se Aktvendimi [PN1. nr. 422/2023] i 28 prillit 2023, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, nuk është më në mënyrë aktive i diskutueshëm për arsye se i njëjti është anuluar përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 251/2023] të 30 majit 2023 të Gjykatës Supreme dhe çështja e vazhdimit të paraburgimit të tij është kthyer në rivendosje në Gjykatën Themelore, dhe se, për rrjedhojë, Aktvendimi i kontestuar para kësaj Gjykate nuk është më tej në fuqi dhe si i tillë, nuk prodhon asnjë efekt juridik për parashtruesin e kërkesës.

Megjithatë, unë, si gjyqtar individual, kam mendim mospajtues në lidhje me konkludimin e shumicës dhe nuk pajtohem me mendimin e shumicës.

Unë, si gjyqtar pajtohem me gjendjen faktike siç është deklaruar dhe paraqitur në Vendimin për refuzimin e kërkesës dhe e pranoj të njëjtën gjendje faktike si të saktë. Gjithashtu, unë, si gjyqtar, pajtohem me mënyrën se si janë parashtruar dhe paraqitur pretendimet e parashtruesit të kërkesës në Vendimin për hedhjen poshtë të kërkesës dhe i pranoj të njëjtat si të sakta.

Megjithatë, unë nuk pajtohem me analizën ligjore dhe qëndrimin e shumicës së rasti nuk është në mënyrë aktive i diskutueshëm. Konsideroj se kjo analizë ligjore është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me praktikën e vetë Gjykatës Kushtetuese dhe atë me rastet: (me Aktgjykimin KI129-22 të 17 gushtit 2023, me parashtruesin Saša Milosavljević; me Aktgjykimin KI55-22 të 5 korrikut 2023, me parashtruesin Saša Spasić; me Aktgjykimin KI85-22 të 23 majit 2023, me parashtruesin Jadran Kostić; si dhe me rastet e bashkuara KI146-23 dhe KI163-23 të 12 marsit 2024, me parashtruesin Nagip Krasniqi).

Gjithashtu, konsideroj se kjo analizë dhe konkluzion i shumicës është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me detyrimin e Gjykatës sipas nenit 53 të Kushtetutës, i cili përcakton detyrimin për Gjykatën që *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*. Duke e theksuar këtë, nuk dëshiroj t'i referohem një rasti individual të GJEDNJ-së, por dëshiroj t'i referohem të gjithë Udhëzuesit për nenin 5 të KEDNJ-së, në të cilin nuk ekziston asnjë rast i vetëm në të cilin GJEDNJ ka shpallur jolëndore rastet e parashtruara në bazë të nenit 5 të KEDNJ-së, përkundrazi, praktika e GJEDNJ-së tregon të kundërtën dhe kemi një numër të madh të rasteve ku GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 5 të KEDNJ-së pikërisht për shkak të një analize të tillë të gjykatave të rregullta dhe gjykatave kushtetuese të shteteve anëtare (shih Udhëzuesin për nenin 5 të KEDNJ-së).

Për atë që u tha më lart, dhe në përputhje me rregullin 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, për ta bërë sa më të lehtë dhe më të qartë ndjekjen e mendimit tim mospajtues, unë, në vijim do të shtjelloj së pari: (i) parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për sa i takon shterimit të mjeteve juridike dhe (ii) praktikën relevante gjyqësore të Gjykatës që ndërlihet me shterimin e mjeteve juridike; dhe më pas (iii) do t'i aplikoj të njëjtat në rrethanat e rastit konkret dhe (iv) do të vlerësoj kriteret e tjera përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës.

Pas kësaj, do t'i rikujtoj pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe do t'i shqyrtoj ato në merita, do të vlerësoj pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe do të paraqes përfundimin tim në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës.

(i) *Parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës sa i përket shterimit të mjeteve juridike*

1. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, në parim, rregulli i shterimit të mjeteve juridike, duhet të zbatohet me një *“shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar”*, duke pasur parasysh kontekstin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, [Ringeisen kundër Austrisë](#), nr. 2614/65, Aktgjykim i 16 korrikut 1971, paragrafi 89; [Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë \[DHM\]](#), nr. 17153/11 dhe 21 kërkesa të tjera, Aktgjykim i 25 marsit 2014, paragrafi 76; dhe [Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë](#), nr. 21893/93, Aktgjykim i 1 prillit 1998, paragrafi 69; si dhe shih rastin e Gjykatës [KI57/22 dhe KI79/22](#), parashtrues [Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti](#), Aktvendim për papranueshmëri i 4 korrikut 2022, paragrafi 73).
2. Megjithatë, në aplikimin e këtij parimi me fleksibilitetin dhe mungesën e formalizmit të tepruar, duhet të vlerësohen dhe plotësohen disa kritere, të cilat janë të përcaktuara përmes praktikave respektive gjyqësore. Në të gjitha rastet, kur mjetet juridike nuk janë shteruar, për të përcaktuar nëse të njëjtat, në rrethanat e rasteve përkatëse, nuk do të ishin *“efektive”*, duhet të vlerësohet nëse (i) ekzistenca e mjeteve juridike është *“mjaf tueshëm e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë”* sepse të njëjtat, duhet të jenë në gjendje *“të ofrojnë zgjidhje përkitazi me pretendimet e një parashtruesi”* dhe *“të ofrojnë një mundësi të arsyeshme për sukses”*; dhe (ii) mjetet juridike përkatëse janë në *“dispozicion, të qasshme dhe efektive”*, karakteristika këto të cilat duhet të jenë

- mjaftueshëm të konsoliduara në praktikën gjyqësore të sistemit përkatës juridik (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lart, [Öcalan kundër Turqisë](#), nr. 46221/99, Aktgjykim i 12 majit 2005, paragrafët 63-72; dhe [Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës](#), nr. 39343/98 dhe 3 të tjerë, Aktgjykim i 6 majit 2003, paragrafët 155-162).
3. Argumentet rreth “*efektivitetit*” ose mungesës së “*efektivitetit*” të mjetit juridik duhet të mbështeten edhe përmes praktikës gjyqësore, ose, respektivisht mungesës së saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Kornakovs kundër Letonisë*, nr. 61005/00, Aktgjykim i 15 qershorit 2006, paragrafët 83-85). Rëndësinë e praktikës gjyqësore, e dëshmon edhe rasti i GJEDNJ-së [Vinčić dhe të tjerët kundër Serbisë](#), në të cilin ankesa në Gjykatën Kushtetuese të Serbisë nuk konsiderohej si efektive, përderisa ajo gjykatë nuk kishte dëgjuar raste që kishin të bëjnë me shkeljet përkatëse të të drejtave të njeriut dhe derisa ajo gjykatë nuk kishte nxjerrë dhe publikuar vendime të tilla në merita (shih, rastin e GJEDNJ-së [Vinčić dhe të tjerët kundër Serbisë](#), nr. 44700/06 dhe 30 të tjera, Aktgjykim i 1 dhjetorit 2009, paragrafi 51). Pra, edhe pse në teori ekzistonte mundësia që parashtruesit t’i drejtoheshin Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, në nivel të GJEDNJ-së, në mungesë të praktikës gjyqësore, mjeti i tillë juridik ishte konsideruar si joefektiv deri në vërtetimin e të kundërtës. Në një fazë të mëvonshme dhe vetëm pas dëshmime konkrete mbi efektivitetin në praktikë të mjetit juridik, GJEDNJ, kishte pranuar argumentet e paraqitura për efektivitetin e krijuar të mjetit juridik duke pranuar dhe kërkuar që shterimi i mjetit të tillë juridik duhet të ndodhë para se një kërkesë të parashtrohet para GJEDNJ-së (shih, rastin e Gjykatës KI57/22 dhe 79/22, parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, cituar më lart, paragrafi 75).
 4. Prandaj, bazuar në të njëjtën praktikë të konsoliduar gjyqësore, parashtruesit përkatës duhet të dëshmojnë se “*ata kanë bërë gjithçka që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme nga ata që të shterojnë mjetet juridike*”, ose parashtruesit duhet të dëshmojnë, duke ofruar praktikën gjyqësore përkatëse ose ndonjë dëshmi tjetër të përshtatshme, se një mjet juridik në dispozicion e të cilin ata nuk e kanë shfrytëzuar, do të dështonte. Për më tepër, “*dyshimet e thjeshta*” të një parashtruesi rreth joefikasitetit të një mjeti juridik, nuk vlejné si arsye për ta liruar një parashtrues nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike (shih rastin e GJEDNJ-së [D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke](#), nr. 57325/00, Aktgjykim i 13 nëntorit 2007, paragrafi 116 dhe referencat e përmendura aty). GJEDNJ potencon se është në interes të parashtruesit të kërkesës që t’i drejtohet gjykatës kompetente për t’i dhënë asaj mundësinë që të ushtrojë të drejtat ekzistuese përmes fuqisë së saj të interpretimit (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së [Ciupercescu kundër Rumanisë](#), nr. 35555/03, Aktgjykim i 15 qershorit 2010, paragrafi 169; si dhe rastin e Gjykatës KI57/22 dhe 79/22, parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, cituar më lart, paragrafi 76).
 5. Në fund, vlerësimi fleksibil i karakteristikave të nevojshme të mjetit juridik, duhet të bëhet duke marrë parasysh vlerësimin në dritën e rrethanave të veçanta të secilit rast individual. Në bërjen e këtij vlerësimi, GJEDNJ merr parasysh edhe (i) kontekstin e përgjithshëm “*ligjor dhe politik*”; dhe (ii) “*rrethanat e veçanta/individuale*” të një parashtruesi (për konceptin e “*rrethanave të veçanta*”, ndër të tjera, shih rastet e GJEDNJ-së *Van Oosterijck kundër Belgjikës*, nr. 7654/76, Aktgjykim i 1 marsit 1979, paragrafët 36-40 dhe referencat përkatëse në të; [Öcalan kundër Turqisë](#), cituar më lart, paragrafi 67; dhe *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafët 67-68 dhe referencat në të. Më tej, lidhur me shqyrtimin e kontekstit të përgjithshëm “*ligjor dhe politik*”, ndër të tjera, shih *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafët 68-69; dhe rastin e Gjykatës KI57/22 dhe 79/22, parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, cituar më lart, paragrafi 77).

(ii) *Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese*

6. Unë do të rikujtoj praktikën gjyqësore në rastet kur Gjykata ka vendosur për papranueshmëri për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike që ndërlidhen me mjetet e jashtëzakonshme të goditjes, praktikë kjo e cila nuk është e konsoliduar dhe do të shtjellohet në vijim.
7. Në lidhje me këtë, i referohem rastit [KI30/17](#), me parashtruesin *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 korrikut 2017, i cili ndërlidhet me faktin se parashtruesi i kërkesës është ankuar kundër një vendimi të Gjykatës së Apelit, përmes të cilit ankesa e tij është aprovuar pjesërisht dhe si rezultat i kësaj ishte zvogëluar shumat e kompensimit të dëmit të përcaktuar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës nuk kishte parashtruar revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit sa i përket kërkesës së tij për të ndryshuar shumat e gjykuara nga Gjykata e Apelit në favor të tij, por revizion kishte parashtruar vetëm pala e paditur ndaj pikës së dytë të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit që ishte në favor të parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur përgjigje ndaj revizionit të palës së paditur. Në këtë rast, Gjykata konstatoi se Gjykata Supreme nuk kishte shqyrtuar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit sa i përket kërkesës së parashtruesit për të ndryshuar shumat e gjykuara nga Gjykata e Apelit pasi parashtruesi nuk kishte paraqitur revizion kundër këtij vendimi të fundit dhe se vetëm përgjigja ndaj revizionit nuk është e mjaftueshme për të konsideruar se i njëjti ka shteruar të gjitha mjetet juridike për të parashtruar kërkesë në Gjykatë. Rrjedhimisht, Gjykata e shpalli kërkesën e parashtruesit të kërkesës të papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike ashtu siç përcaktohet me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
8. Në vijim, i referohem edhe rastit [KIo1/10](#), me parashtruesin *Gani Ibërdemaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 prillit 2010. Në këtë rast, parashtruesi i kërkesës kontestonte Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të nxjerrë në një procedurë civile. Gjykata e shpalli kërkesën e parashtruesit të kërkesës të papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike ashtu siç përcaktohet me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
9. Gjithashtu, theksoj edhe praktikën gjyqësore në vlerësimin e akteve të autoriteteve publike bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, ku Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka vlerësuar pranueshmërinë e kërkesave të individëve, të cilët kanë pretenduar shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me Kushtetutë si rezultat i dështimit për t'u zgjedhur dhe/ose emëruar në funksione publike nga institucionet e Republikës, përfshirë akte të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv. Të gjitha këto kërkesa janë shpallur të papranueshme si pasojë e mosshterimit të mjeteve juridike (shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KIo9/21](#), parashtrues *Sadat Lekiqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 prillit 2021). Rastet e Gjykatës [KI114/10](#) (parashtruese *Vahide Badivuku*, Aktvendim për papranueshmëri i 18 majit 2010); [KI139/11](#) (parashtrues *Ali Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 marsit 2012); [KI130/12](#) (parashtrues *Xhymshit Xhymshiti*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 marsit 2013); [KI145/15](#) (parashtrues *Florent Muçaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 14 marsit 2016); [KI42/20](#) (parashtrues *Armend Hamiti*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 korrikut 2020); [KI43/20](#) (parashtruese *Fitore Sadikaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 korrikut 2020); [KI164/20](#) (parashtrues *Rafet Haxhaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 janarit 2021), si dhe rastet e bashkuara KI57/22 dhe KI79/22 (parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, Aktvendim për papranueshmëri i 4 korrikut 2022), janë aktvendime për papranueshmëri, për shkak se nuk ishin shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj

(shih për më shumë, rastin e Gjykatës KI57/22 dhe KI79/22, parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, cituar më lart, paragrafi 80).

10. Po ashtu, nënvizoj se në praktikën e saj të deritanishme, Gjykata ka bërë përjashtime nga shterimi i mjeteve juridike vetëm në 6 (gjashtë) raste, përkatësisht në rastet (i) [KI56/09](#), parashtrues *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2010; (ii) [KI06/10](#), parashtrues *Valon Bislimi*, Aktgjykim i 30 tetorit 2010; (iii) [KI41/12](#), parashtrues *Gëzim dhe Makfire Kastrati*, Aktgjykim i 25 janarit 2013; (iv) [KI99/14 dhe KI100/14](#), parashtrues *Shyqri Sylja dhe Laura Pula*, Aktgjykim i 3 korrikut 2014; (v) [KI34/17](#), parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017. godine; dhe (vi) [KI55/17](#), parashtruese *Tonka Berisha*, Aktgjykim i 5 korrikut 2017. Tri aktgjykimet e fundit ndërlidhen me kontestimin e procedurave për zgjedhjen, përkatësisht propozimin për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, në vitin 2014, dhe propozimin për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit, respektivisht, në vitin 2017. Që nga këto të fundit, praktika gjyqësore e Gjykatës nuk ka asnjë përjashtim në kuptim të detyrimit të shterimit të mjeteve juridike, siç përcakton paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës.
11. Rikujtoj se praktika e lartcekur gjyqësore e Gjykatës në rastet KI99/14 dhe KI100/14, KI34/17 dhe KI55/17 [kontestimi i vendimeve të KPK-së dhe KGJK-së, që ndërlidhen me propozimin për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe emërimin në pozitat e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës së Apelit, respektivisht] tashmë nuk është aktuale, për arsye se në rastet KI57/22 dhe KI79/22 [parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*] e njëjta ndryshe nga qëndrimi i mëparshëm i saj, vendosi se parashtruesit e kërkesës, të cilët kanë aplikuar për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kanë kontestuar Vendimin e KPK-së, përmes të cilit ishte propozuar një kandidat tjerët për këtë pozitë, nuk i kishin shteruar mjetet juridike, dhe rrjedhimisht vendosi që kërkesat përkatëse t'i shpallë të papranueshme mbi baza procedurale.
12. Duke marrë parasysh rrethanat e rastit konkret, në vijim do të paraqes vetëm praktikën gjyqësore në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së rasteve që ndërlidhen me kontestimin e aktvendimeve të gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë dhe vazhdimin e paraburgimit, përkatësisht rasteve [KI85/22](#) [parashtrues *Jadran Kostić*, Aktgjykim i 26 prillit 2023], [KI55/22](#) [parashtrues *Saša Spasić*, Aktgjykim i 23 majit 2023] dhe [KI129/22](#) [parashtrues *Saša Milosavljević*, Aktgjykim i 28 korrikut 2023], e cila praktikë gjyqësore nuk është e konsoliduar.
13. Fillimisht, rikujtoj rastin KI85/22, në të cilin parashtruesi i kërkesës para Gjykatës kontestoi Aktvendimin e Gjykatës së Apelit për vërtetimin e vazhimit të paraburgimit dhe në të njëjtën kohë parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme. Gjykata e shpalli rastin konkret të pranueshëm për shkak se në rrethanat specifike të këtij rasti, kërkesa e parashtruesit të kërkesës në rastin KI85/22 për mbrojtje të ligjshmërisë, e parashtruar në Gjykatën Supreme në kuptim të mjetit efektiv juridik kishte rezultuar e pasuksesshme për arsye se kjo e fundit nuk kishte adresuar në merita pretendimet e tij të ngritura në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë duke e hedhë poshtë kërkesën e tij si jolëndore (shih rastin e Gjykatës KI85/22, parashtrues *Jadran Kostić*, cituar më lart, paragrafi 56).
14. Në rastin KI55/22, parashtruesi i kërkesës kontestoi kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Themelore për vazhdimin e paraburgimit, dhe më pas, si rezultat i dorëzimit të dokumentacionit shtesë dhe plotësimit të formularit të Gjykatës, specifikoi se konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit për vërtetimin e vazhimit të paraburgimit. Gjykata këtë rast e shpalli të pranueshëm duke pasur parasysh pretendimin e parashtruesit të kërkesës se ai kishte kontestuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore tek Gjykata e Apelit, por që për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nuk kishte marrë përgjigje

- nga e njëjta dhe rrjedhimisht kishte vendosur që të dorëzojë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, me ç'rast kjo e fundit konstatoi se parashtruesi i kërkesës i kishte shterur mjetet juridike dhe se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit në ndërlidhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore do të jenë objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë (shih rastin e Gjykatës KI55/22, parashtrues *Saša Spasić*, cituar më lart, paragrafët 78-80).
15. Në rastin KI129/22, parashtruesi i kërkesës kontestoi kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit në ndërlidhje me Aktvendimin e Gjykatës Themelore për vazhdimin e paraburgimit dhe në ndërkohë parashtrroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, të cilin po ashtu Gjykata Supreme e hodhi poshtë si jolëndore. Ngjashëm si në rastin KI85/22, Gjykata në rastin KI129/22 vendosi që rastin ta shpallë të pranueshëm, pasi që konstatoi se parashtruesi i kërkesës i kishte ngritur pretendimet e tij në tri instancat gjyqësore (shih rastin e Gjykatës KI129/22, parashtrues *Saša Milosavljević*, cituar më lart, paragrafët 66-68).
16. Lidhur me këtë, theksoj se tri rastet e elaboruara më sipër, Gjykata i shpalli të pranueshme për shkak të rrethanave specifike që i kanë karakterizuar procedurat e ankimit në rastet konkrete.
- (iii) *Aplikimi i parimeve të lartcekura në rastin konkret*
17. Para se të vazhdoj me vlerësimin e kriterit të shterimit të mjeteve juridike, rikujtoj se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me procedurën e caktimit dhe vazhdimin të masës së paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës. Rikujtoj se objekt i shqyrtimit të kërkesës së parashtruesit është Aktvendimi [PN1. nr. 422/2023] i 28 prillit 2023, i Gjykatës së Apelit, përmes të cilit u vërtetua Aktvendimi [PKR. nr. 239/22] i 7 prillit 2023, i Gjykatës Themelore, si dhe parashtruesit të kërkesës iu vazhdua paraburgimi nga 8 prilli deri më 7 qershor 2023.
18. Rikujtoj se në bazë të parimeve të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, si dhe bazuar në analizën krahasuese për shterimin e mjeteve juridike, të shtjelluara më lart, konsideroj se gjatë aplikimit të tyre në rrethanat e rastit konkret, duhet të vlerësohet nëse (i) mjetet juridike të cilat parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar, nuk janë “*mjaftueshëm të sigurta jo vetëm në teori, por edhe në praktikë*” sepse të njëjtat nuk mund “*të ofrojnë zgjidhje përkitazi me pretendimet e një parashtruesi*” dhe “*të ofrojnë një mundësi të arsyeshme për sukses*”; (ii) nuk janë në “*dispozicion, të qasshme dhe efektive*”; dhe (iii) nëse parashtruesi i kërkesës “*ka bërë gjithçka që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme nga ai që të shterojë mjetet juridike*”, duke marrë parasysh gjithashtu se “*dyshimet e thjeshta*” e një parashtruesi rreth joefikasitetit të një mjeteve juridike, nuk vlejné si arsye për ta liruar një parashtrues nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike të përcaktuara me Kushtetutë (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI211/19, parashtrues *Hashim Gashi, Selajdin Isufi, B.K., H.Z., M.H., R.S., R.E., S.O., S.H., H.I., S.S., N.S. dhe S.R.*, cituar më lart, paragrafët 56 dhe 57; KI108/18, cituar më lart, paragrafi 157; KI57/22 dhe KI79/22, parashtrues *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, cituar më lart, paragrafi 104; dhe shih, po ashtu, rastet e GJEDNJ-së *Aktivuar dhe të tjerët kundër Turqisë*, cituar më lart; *Öcalan kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafët 63-72; *Kleyn dhe të tjerët kundër Holandës*, cituar më lart, paragrafët 155-162; dhe *Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë*, cituar më lart, paragrafi 74).
19. Përkitazi me dy kriteret e para, vërej se parashtruesi i kërkesës pretendon që ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion për shkak se konsideroi që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme nuk paraqet mjet efektiv juridik, dhe në lidhje me këtë thirrret në rastin e Gjykatës KI85/22, me parashtruesin *Jadran Kostić*, të cituar më lart. Unë sqaroj se në Aktgjykimin e saj të lartcekur, Gjykata konsideroi se në rrethanat specifike të parashtruesit të kërkesës në rastin KI85/22, Gjykata kishte marrë për bazë

- Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, si vendim të fundit, përmes të cilit është shqyrtuar çështja e vazhdimit të paraburgimit të tij, pasi që kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë në kuptim të mjetit efektiv juridik kishte rezultuar e pasuksesshme dhe kjo për shkak se Gjykata Supreme e kishte hedhur atë si jolëndore (shih, rastin e Gjykatës KI85/22, parashtrues *Jadran Kostić*, cituar më lart, paragrafi 56).
20. Në këtë kontest, unë theksoj dispozitat që rregullojnë procedurën e ankimimit në procedurën penale për vazhdimin e paraburgimit, gjegjësisht paragrafin 4 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të KPPRK-së, i cili përcakton: *“4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit”*.
 21. Unë po ashtu i referohem dispozitave për efektet juridike të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë pas shqyrtimit nga ana e Gjykatës Supreme, ku në paragrafin 2 të nenit 435 (Shqyrtimi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga kolegji i Gjykatës Supreme) të KPPRK-së, parashihet se: *“Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendim e hedh kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nëse kërkesa është e papranueshme ose janë plotësuar kushtet nga neni 434 paragrafit 2 i këtij Kodi. Në të kundërtën, kopjen e kërkesës ia dërgon palës tjetër, e cila në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës mund të paraqesë përgjigje në kërkesë”,* ndërsa në nenin 437 (Refuzimi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të KPPRK-së dhe paragrafin 1 të nenit 438 (Aktgjykimi mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë) të KPPRK-së, përcaktohet kur Gjykata Supreme vendos meritorisht për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.
 22. Më konkretisht, theksoj se neni 437 i KPPRK-së përcakton se: *“Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykim refuzon si të pabazë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kur vërteton se nuk ekziston shkelje e ligjit për të cilën pretendon paraqitësi i kërkesës, ose kur kërkesa është paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike nga nenet 386 dhe 432, paragrafit 2 i këtij Kodi”,* kurse paragrafi 1 i nenit 438 të KPPRK-së parashihet se: *“Kur Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, merr aktgjykim me të cilin, duke pasur parasysh llojin e shkeljes: 1.1. ndryshon vendimin e formës së prerë; 1.2. në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë ose vetëm vendimin e gjykatës më lartë dhe lëndën për vendim të ri mbi meritat ose për rigjykim ia kthen gjykatës themelore ose gjykatës më të lartë; ose 1.3. kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit”*.
 23. Nga ky elaborim rezulton që mjeti juridik, përkatësisht kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është (i) e përcaktuar me dispozitat e KPPRK-së dhe në mënyrë të qartë përkufizohet me legjislacionin në fuqi, dhe (ii) ky mjet juridik është drejtpërsëdrejti i qashtë për parashtruesit e kërkesës ashtu siç përcaktohet me nenin 432 të këtij Kodi. Rrjedhimisht, vlerësoj se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, si mjet i jashtëzakonshëm juridik në procedurë penale i cili parashtrohet në Gjykatën Supreme, mund (i) të ofrojë zgjidhje përkitazi me pretendimet e një parashtruesi dhe (ii) të ofrojë një mundësi të arsyeshme për sukses.
 24. Në rrethanat e rastit të tanishëm, rikujtoj se Aktvendimin paraprak për vazhdimin e paraburgimit të Gjykatës Themelore dhe të vërtetuar nga Gjykata e Apelit, gjegjësisht, Aktvendimin [PN1. nr. 239/2023], të 8 marsit 2023, të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës e kishte kontestuar në Gjykatën Supreme përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, në të cilën kërkesë, Gjykata Supreme për dallim nga rasti KI85/22, kishte vendosur meritorisht përmes Aktgjykimit [PML. nr. 138/2023], të 6 prillit 2023, përkatësisht e kishte refuzuar si të *“pathemeltë”*. E njëjta gjë vlen edhe për Aktvendimin

[PKR. nr. 239/2022], të 7 qershorit 2023, të Gjykatës së Apelit, për vërtetimin e vazhdimin të paraburgimit, të cilin parashtruesi i kërkesës, pas parashtrimin të kërkesës aktuale para Gjykatës, e kishte kontestuar në Gjykatën Supreme përmes kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, e cila kërkesë kësaj radhe rezultoi e suksesshme. Kjo për shkak se më 26 korrik 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 359/2023], e kishte aprovuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruesit të kërkesës duke ia kthyer çështjen në rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

25. Gjykata po ashtu vëren, bazuar në shkresat shtesë të lëndës, se J.K, një nga të bashkëpandehurit e tjerë të parashtruesit të kërkesës, të cilit i është vazhduar paraburgimi me të njëjtin vendim dhe për të njëjtën periudhë si parashtruesit të kërkesës, gjegjësisht me Aktvendimin [PN1. nr. 422/2023], të 28 prillit 2023, të Gjykatës së Apelit, kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të kontestuar, me ç'rast, Gjykata Supreme kishte aprovuar atë dhe kishte kthyer në rivendosje çështjen në fjalë.
26. Lidhur me këtë, konstatoj se bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në rrethanat e rastit konkret, ku në të tri rastet e lartcekura, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë rezulton të ketë qenë efektive pasi që ka adresuar pretendimet e ankuesit meritorisht, ky mjet juridik është *“mjaftueshëm i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë”*, i njëjti mund *“të ofrojë zgjidhje përkitazi me pretendimet e një parashtruesi”* dhe *“të ofrojë një mundësi të arsyeshme për sukses”*; si dhe është në *“dispozicion, i qasshëm dhe efektiv”*.
27. Për më tepër, theksoj se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës duhet të argumentojë se *“ai ka bërë gjithçka që mund të pritët në mënyrë të arsyeshme nga ai që të shterojë mjetet juridike”*. Në rrethanat e rastit konkret, ky nuk është rasti sepse parashtruesi i kërkesës shprehimisht e njofton Gjykatën se nuk ka shterur kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të kontestuar, si mjet i jashtëzakonshëm juridik në rastet e goditjes së aktvendimeve të Gjykatës së Apelit për vërtetimin e vazhdimin të paraburgimit.
28. Në këtë rast të parashtruesit të kërkesës, unë i sqaroj qartazi këto parime dhe konsolidon praktikën e saj gjyqësore përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në kontekst të kontrollit individual, përkatësisht kërkesave të parashtruara në kuadër të fushëveprimit të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës. Për më tepër, Gjykata, në raste të rralla dhe vetëm atëherë kur e ka vlerësuar tejet të domosdoshme, përtej konsolidimit dhe sqarimit të praktikës së saj gjyqësore, edhe ka ndryshuar praktikën e saj gjyqësore, siç është rasti KO79/18 përkitazi me juridiksionin e saj për të trajtuar *“çështjet kushtetuese”* jashtë kufijve të nenit 113 të Kushtetutës (shih, rastin e Gjykatës [KO79/18](#), parashtrues: *Presidenti i Republikës së Kosovës*, Aktvendim për papranueshmëri i 21 nëntorit 2018). Një qasje e tillë, është edhe në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatave tjera Kushtetuese por edhe GJEDNJ-së. Në këtë kontekst dhe ndër të tjera, GJENDJ, përmes praktikës së saj gjyqësore, ka sqaruar që përderisa ajo nuk është formalisht e detyruar që të ndjek praktikën e saj gjyqësore paraprake, në interes të parimit të sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, nuk duhet të devijojë nga praktika e saj gjyqësore, pa ndonjë arsye të fortë. Megjithatë, në raste të caktuara e njëjta gjithashtu ka sqaruar, konsoliduar dhe ndryshuar praktikën e saj gjyqësore (shih, ndër të tjera, [Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë](#), nr. 37374/05, Aktgjykim i 14 prillit 2009, paragrafi 35; [Mamatkulov dhe Askarov kundër Turqisë](#), nr. 46827/99 dhe 46951/99, Aktgjykim i 6 shkurtit 2003, paragrafi 121, [Chapman kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 2723/95, Aktgjykim i 18 janarit 2011, paragrafi 70; [Micallef kundër Maltës](#), nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafët 74-82). Një qëndrim të tillë Gjykata e ka marrë edhe në rastet KI57/22 dhe KI79/22, me parashtruesit e kërkesës *Shqipdon Fazliu dhe Armend Hamiti*, kur ka ndryshuar praktikën gjyqësore

në lidhje me shterimin e mjeteve juridike në rastet që ndërlidhen me kontestimin e procedurave për zgjedhjen, përkatësisht propozimin për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, në vitin 2014 dhe propozimin për pozitën e Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës së Apelit, respektivisht, në vitin 2017.

29. Rrjedhimisht, bazuar në atë që u tha më sipër dhe në pajtim me standardet e vendosura në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe duke u mbështetur në parimin e subsidiaritetit që t'u ofrojë organeve kompetente, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës, konstaton se në procedurën e paraburgimit, personat fizikë duhet të shterin të gjitha mjetet juridike, të cilat janë: (i) në dispozicion; (ii) të qasshme; (iii) efektive; (iv) ofrojnë një mundësi të arsyeshme për sukses; dhe (v) të bëjnë gjithçka që mund të pritët në mënyrë të arsyeshme nga ata/ato që të shterojnë mjetet juridike, ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 të Rregullores së punës, ose në të kundërtën kërkesat e tilla duhet të shpallen të papranueshme.
30. Rikujtoj se praktika gjyqësore e Gjykatës, e cila nuk është e konsoliduar sa i përket rasteve të shterjes së mjeteve juridike në procedurën e vazhdimit të paraburgimit, dhe e njëjta rithekson se përjashtimet e deritanishme në shterimin e këtij kriteri, respektivisht, rastet KI85/22, KI55/22 dhe KI129/22, kanë të bëjnë me rrethanat specifike të parashtruesve të këtyre kërkesave dhe ndërlidhen me rrethanat faktike shumë të ngjashme me rastin konkret para Gjykatës.
31. Megjithatë, duke pasur parasysh këto tri përjashtime, të cilat ndërlidhen edhe me rrethanat e rastit konkret, Gjykata, përjashtimisht, kërkesën e parashtruesit të kërkesës e shpallë të pranueshme, ndërsa prej momentit të publikimit të këtij aktgjykimi, e njëjta e konsolidon praktikën e saj gjyqësore sa i përket plotësimit të kriterit të shterimit të mjeteve juridike në procedurën e caktimit dhe vazhdimit të paraburgimit në përputhje me kriteret dhe parimet e përgjithshme të elaboruara më lart.
32. Andaj, në dritën e kësaj që u tha më lart, konsideroj se Gjykata duhet të kishte marrë për bazë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, si vendimin e fundit, përmes të cilit do të shqyrtohet çështja e vazhdimit të paraburgimit të parashtruesit të kërkesës.

(iv) Vlerësimi i kriterëve të tjera lidhur me pranueshmërinë e kërkesës

33. Unë do të vazhdoj më tej me shqyrtimin nëse kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës. Marrë për bazë faktin që objekt i shqyrtimit të kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [PN1. nr. 422/2023], të 28 prillit 2023, të Gjykatës së Apelit, në lidhje me Aktvendimin [PKR. nr. 239/22], të 7 prillit 2023, të Gjykatës Themelore, unë konstatoj se Aktvendimi i lartcekur i Gjykatës së Apelit është nxjerrë më 28 prill 2023, përderisa parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar në Gjykatë më 5 qershor 2023. Rrjedhimisht, vlerësoj se parashtruesi i kërkesës, kërkesën e tij e ka dorëzuar brenda afatit të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës.
34. Unë, gjithashtu, konstatoj se kërkesa e parashtruesit të kërkesës i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara përmes paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit (3) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

35. Për më tepër dhe në fund, vlerësoj se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, ajo duhet të deklarohet e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.

Meritat

36. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, unë fillimisht do të rikujtoj esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave do të aplikoj standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
37. Në këtë aspekt, dhe në fillim, rikujtoj se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me Aktvendimin [PN1. nr. 422/2023] të 3 majit 2023, të Gjykatës së Apelit, përmes të cilit është vërtetuar Aktvendimi [PKR. nr. 239/22] i 7 prillit 2023, të Gjykatës Themelore për vazhdimin e paraburgimit të parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurve të tjerë, për periudhën prej 8 prillit deri më 7 qershor 2023. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës gjendet në paraburgim që nga 23 dhjetori 2021 deri së paku në kohën e parashtrimit të kësaj kërkesë para Gjykatës, për shkak të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprave penale gjatë lëshimit të lejeve ndërtimore në Parkun Kombëtar "Shari" si në vijim: "*Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar*" nga paragrafi 1 i nenit 422 të KPRK-së, "*Marrje e ryshfetit*" nga paragrafi 2 i nenit 428 të KPRK-së, "*Ushttrim i ndikimit*" nga paragrafi 1 i nenit 431 të KPRK-së dhe "*Mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve*" nga paragrafi 1 i nenit 366 të KPRK-së në fuqi. Gjykata Themelore në Ferizaj dhe më pas ajo në Pejë, për shkak të transferimit të lëndës, ia kishte vazhduar paraburgimin parashtruesit të kërkesës gjithsej 8 (tetë) herë para ngritjes së aktakuzës. Më 9 dhjetor 2022, Prokuroria Themelore në Ferizaj ngriti aktakuzë ndaj parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurve të tjerë, të cilën e plotësoi më 24 shkurt 2023. Që nga ngritja e aktakuzës deri në kohën e parashtrimit të kësaj kërkesë para Gjykatës, parashtruesit të kërkesës i është vazhduar paraburgimi edhe 3 (tri) herë, përfshirë Aktvendimin e kontestuar. Pas marrjes së informatave shtesë rezultoi se pas parashtrimit të kërkesës në Gjykatë, Gjykata Themelore ia kishte vazhduar paraburgimin edhe 2 (dy) herë deri më 1 shtator 2023, kur përmes Aktvendimit [PKR. 239/22], e liroi nga paraburgimi parashtruesin e kërkesës dhe i caktoi masën e dorëzimit në vlerë prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) euro.
38. Më tej, theksoj se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës si vendimin e fundit të autoritetit publik kontestoi Aktvendimin [PN1. nr. 422/2023] e 3 majit 2023 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [PKR. nr. 239/22] e 7 prillit 2023, të Gjykatës Themelore për vazhdimin e paraburgimit të parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurve të tjerë. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon në esencë se (i) Aktvendimi i kontestuar nuk përmbush standardet e vendimit të arsyetuar gjyqësor dhe nuk adreson pretendimet e tij në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 3 të nenit 5 të KEDNJ-së; si dhe (ii) vazhdimi i paraburgimit të tij nuk është "*i ligjshëm*" në kuptim të paragrafit 4 të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 4 të nenit 5 të KEDNJ-së.
39. Në këtë drejtim, unë do të shqyrtoj dhe elaboroj: (i) parimet dhe kriteret lidhur me caktimin e paraburgimit; (ii) parimet dhe kriteret lidhur me mosarsyetimin e vendimit gjyqësor në kuptim të paragrafit 2 të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 3 të nenit 5 të KEDNJ-së; (iii) parimet dhe kriteret lidhur me ligjshmërinë e vazhdimit të paraburgimit në kuptim të paragrafit 2 të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 4 të nenit 5 të KEDNJ-së, si dhe të njëjtat do t'i zbatoj në rastin e parashtruesit të kërkesës veç e veç. Lidhur me këtë, Gjykata vë në pah se përmes Aktvendimit të kontestuar konfirmohet vazhdimi i paraburgimit për herën e tretë për

parashtruesin e kërkesës dhe të pandehurit e tjerë pas ngritjes së aktakuzës, andaj, Gjykata gjatë vlerësimit të saj, do të fokusohet në shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me vazhdimin e paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës, gjegjësisht nga 9 dhjetori 2022. Kjo edhe për faktin se sipas KPPRK-së, pas ngritjes së aktakuzës nuk ekzistojnë afate kohore maksimale që i pandehuri mund të qëndrojë në paraburgim, gjegjësisht nenin 190 (Caktimi, vazhdimi dhe heqja e paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës) të KPPRK-së përcakton se: *“Pas ngritjes së aktakuzës dhe deri në shpallje të aktgjykimit apo seancën për caktimin e dënimit, nëse ka të tillë, paraburgimi mund të caktohet, vazhdohet ose të hiqet vetëm me aktvendim të gjyqtarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose trupit gjykues në seancë [...]”*.

I. Përkitazi me caktimin e paraburgimit

40. Lidhur me këtë, rikujtoj se, për të qenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, arrestimi ose heqja e lirisë duhet të bazohet në një nga arsyet për heqjen e lirisë nga paragrafi 1 i nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së.

41. Unë fillimisht rikujtoj pikën 2 të paragrafit 1 të nenit 29 të Kushtetutës që përcakton se:

“1. Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:

[...]

(2) për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjyqimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;
[...]”

42. Së dyti, po ashtu i referohem pikës c) të paragrafit 1 të nenit 5 të KEDNJ-së, e cila përcakton se:

“Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

[...]

c. kur arrestohet ose ndalohej ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj”.

43. Përkitazi me parimet dhe kriteret për caktimin e paraburgimit, të garantuara me nenin 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, unë fillimisht theksoj se Gjykata tashmë ka një praktikë gjyqësore, e cila është ndërtuar duke u bazuar në parimet e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së a (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet: [KI10/18](#), parashtrues *Fahri Deçani*, Aktgjykim i 21 tetorit 2019; [KI73/20](#), parashtrues *Esat Bajrami*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 nëntorit 2020; [KI63/17](#), parashtrues *Lutfi Dervishi*, Aktvendim për papranueshmëri i 16 nëntorit 2017; [KI07/22](#) parashtrues *Miljan Košanin*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 qershorit 2022; [KI85/22](#), parashtrues *Jadran Kostić*, Aktgjykim i 27 prillit 2023; [KI55/22](#),

parashtrues *Saša Spasić*, Aktgjykim i 23 majit 2023; dhe [KI129/22](#), parashtrues *Saša Milosavljević*, Aktgjykim i 28 korrikut 2023). Thënë këtë, rastet e Gjykatës përmes të cilave Gjykata ka afirmuar parimet e vendosura nga GJEDNJ dhe të njëjtat i ka aplikuar edhe në rastet për shqyrtim para saj, përfshijnë, por nuk kufizohen në rastet [Merabishvili kundër Gjeorgjisë](#), [DHM], nr. 72508/13, Aktgjykim i 28 nëntorit 2017; [Ostendorf kundër Gjermanisë](#), nr. 15598/08, Aktgjykim i 7 marsit 2013; [Douiye kundër Holandës](#), [DHM], nr. 31464/96, Aktgjykim i 4 gushtit 1999; [Idalov kundër Rusisë](#), [DHM], nr. 5826/03, Aktgjykim i 22 majit 2022; [Reinprecht kundër Austrisë](#), nr. 67175/01, Aktgjykim i 15 nëntorit 2005; [Suso Musa kundër Maltës](#), nr. 42337/12, Aktgjykim i 23 korrikut 2013; [Koendjibharie kundër Holandës](#), nr. 11487/85, Aktgjykim i 25 tetorit 1990.

44. Në këtë kontekst, vërej se në bazë të pikës 2 të paragrafit 1 të nenit 29 të Kushtetutës dhe pikës c të paragrafit 1 të nenit 5 të KEDNJ-së, privimi i lirisë mund të bëhet në rast të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale, dhe kur një gjë e tillë konsiderohet e domosdoshme për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale ose largimin pas kryerjes së saj (shih rastet e Gjykatës, [KI10/18](#), parashtrues *Fahri Deqani*, rast i cituar më lart, paragrafi 65, dhe [KI85/22](#), parashtrues *Jadran Kostić*, cituar më lart, paragrafi 68).
45. Prandaj, theksoj se, për të qenë në përputhje me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, caktimi i paraburgimit duhet të ketë mbështetje në njërën nga bazat për privimin e lirisë të përcaktuara me nenin 29 të Kushtetutës në lidhje me pikën c të paragrafit 1 të nenit 5 të KEDNJ-së.
46. GJEDNJ, në praktikën e saj gjyqësore, të afirmuar edhe nga Gjykata, ka përcaktuar tri kriteret themelore, që duhet ekzaminuar për të vlerësuar nëse privimi i lirisë është i ligjshëm dhe jo arbitrar (shih rastin e GJEDNJ-së, *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, cituar më lart, paragrafi 183; shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës, [KI10/18](#), parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 67; dhe [KI85/22](#), parashtrues *Jadran Kostić*, cituar më lart, paragrafi 70).
47. Së pari, duhet të ekzistojë “*dyshimi i bazuar*” që një person i privuar nga liria ka kryer një veprë penale (shih rastin e GJEDNJ-së, *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, cituar më lart, paragrafi 184). Së dyti, qëllimi i privimit të lirisë është “*që në parim duhet të jetë në funksion të zbatimit të procedurës penale*” (shih, rastet e Gjykatës, [KI63/17](#), parashtrues *Lutfi Dervishi*, cituar më lart, paragrafi 57, dhe [KI10/18](#), parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 68; shih po ashtu rastin e GJEDNJ-së, *Ostendorf kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 68), dhe që për më tepër, duhet të jetë proporcional, në kuptimin që duhet të jetë i nevojshëm “*për të siguruar paraqitjen e personit të afektuar para autoriteteve kompetente përkatëse*” (shih, rastin e Gjykatës [KI63/17](#), parashtrues *Lutfi Dervishi*, cituar më lart, paragrafi 57, shih po ashtu rastin e lartcekur të GJEDNJ-së *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, paragrafi 185). Së treti, privimi i lirisë apo caktimi i paraburgimit duhet të jetë bërë duke ndjekur procedurën e përcaktuar me ligj (shih, rastet e Gjykatës [KI10/18](#), parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 68, dhe [KI85/22](#), parashtrues *Jadran Kostić*, cituar më lart, paragrafi 71, si dhe rastin e GJEDNJ-së *Merabishvili kundër Gjeorgjisë*, cituar më lart, paragrafi 186).

II. Përkitazi me pretendimet në lidhje me mosarsyetimin e vendimit gjyqësor, në kuptim të paragrafit 2 të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 3 të nenit 5 të KEDNJ-së

48. Në kontekst të pretendimit për mosarsyetim të vendimit gjyqësor, rikujtoj se parashtruesi i kërkesës thekson që Gjykata e Apelit në mënyrë arbitrare ka interpretuar

dispozitat e KPPRK-së në lidhje me rreziqet procedurale të cilat shërbejnë si bazë për caktimin dhe vazhdimin e paraburgimit.

49. Në vazhdim, unë do të trajtoj parimet dhe kriteret e vendosura nga Gjykata dhe GJEDNJ përkitazi me këtë pretendim, dhe më pas të njëjtat do t'i aplikoj në rrethanat e rastit konkret.

(i) *Parimet dhe kriteret për mosarsyetimin e vendimit gjyqësor në kuptim të paragrafit 2 të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 3 të nenit 5 të KEDNJ-së*

50. Fillimisht, theksoj se përkitazi me kriteret themelore ligjore në lidhje me paraburgimin në pritje të gjykimit do t'i referohem parimeve dhe standardeve të përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së të aplikuara nga Gjykata në rastin e saj të lartcekur, KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, në kuptim të paragrafit 2 të nenit 29 të Kushtetutës dhe paragrafit 3 të nenit 5 të KEDNJ-së.
51. Më tej, theksoj se në përcaktimin e kohëzgjatjes së paraburgimit në pritje të gjykimit, sipas paragrafit 2 të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 3 të nenit 5 të KEDNJ-së, periudha e paraburgimit fillon ditën kur i akuzuari merret në paraburgim dhe mbaron në ditën kur është liruar apo gjykata e shkallës së parë ka vendosur në lidhje me aktakuzën (shih rastet e GJEDNJ-së, [Štvrtecký kundër Sllovakisë](#), nr. 55844/12, Aktgjykim i 5 qershorit 2018, paragrafi 55; [Solmaz kundër Turqisë](#), nr. 27561/02, Aktgjykim i 16 janarit 2017, paragrafët 23 dhe 24, si dhe rastin e Gjykatës KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 71).
52. Duke iu referuar paragrafit 2 të nenit 29 të Kushtetutës dhe paragrafit 3 të nenit 5 të KEDNJ-së, theksoj se dyshimi i bazuar që një person i privuar nga liria ka kryer një vepër penale konsiderohet si element thelbësor për caktimin e paraburgimit dhe/ose vazhdimin e paraburgimit në pritje të gjykimit.
53. GJEDNJ në praktikën e saj të afirmuar edhe nga Gjykata, ka nënvizuar se arsyeshmëria e një periudhe kohore të kaluar në paraburgim nuk mund të vlerësohet në terma abstraktë, por duhet të vlerësohet mbi bazën e fakteve të secilit rast individual dhe sipas karakteristikave specifike të rastit. Vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ka dëshmi të një kërkesë reale të interesit publik, e cila pavarësisht prezumimit të pafajësisë, është e një peshe më të madhe se norma për respektimin e lirisë individuale, e përcaktuar në nenin 5 të KEDNJ-së (shih, rastin e Gjykatës, KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 73, dhe rastet e GJEDNJ-së, [Buzadji kundër Moldavisë](#), nr. 23755/07, Aktgjykim i 5 korrikut 2016, paragrafi 90, shih, po ashtu, rastin [Labita kundër Italisë](#), [DHM], nr. 26772/95, paragrafi 152, si dhe rastin [Kudła kundër Polonisë](#), [DHM], nr. 30210/96, paragrafi 110).
54. Sipas praktikës dhe vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, nuk ekziston një afat kohor i caktuar që do të mund të aplikohet si standard për secilin rast (shih rastin e Gjykatës KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 74, shih, *mutatis mutandis*, edhe rastin e GJEDNJ-së, [McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), [DHM] nr. 543/03, Aktgjykim i 3 tetorit 2006, paragrafët 41-45, si dhe rastin e Gjykatës KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 74).
55. Më tej, praktika e Gjykatës Kushtetuese është që gjykatat e rregullta duhet të shqyrtojnë dhe përcaktojnë se përveç dyshimit të bazuar ekzistojnë edhe arsye të tjera, të cilat vazhdojnë ta justifikojnë paraburgimin në pritje të gjykimit (shih rastin e Gjykatës KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 75, si dhe rastet e GJEDNJ-së, [Letellier kundër Francës](#), nr. 12369/86, Aktgjykim i 26 qershorit 1991,

paragrafi 35; dhe rastin [Yağcı dhe Sargın kundër Turqisë](#), nr. 16419/90 dhe 16426/90, Aktgjykim i 8 qershorit 1995, paragrafi 50).

56. Si rrjedhojë, GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore ka përcaktuar katër arsye themelore të rëndësishme për vazhdimin e paraburgimit, përkatësisht: 1) rrezikun e arratisjes; 2) ndërhyrjen në gjykatë; 3) parandalimin e krimit, dhe 4) nevojën për të ruajtur rendin publik (shih rastet e GJEDNJ-së [Tiron kundër Rumanisë](#), nr. 17689/03, Aktgjykim i 7 prillit 2009, paragrafi 37; rastin [Smirnova kundër Ruisë](#), nr. 46133/99 dhe 48183/99, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 59; rastin [Piruzyan kundër Armenisë](#), nr. 33376/07, Aktgjykim i 26 shtatorit 2012, paragrafi 94). Këto parime Gjykata i ka aplikuar në praktikën e saj gjyqësore përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet e saj, KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 77, dhe [KI73/20](#), parashtrues *Esat Bajrami*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 50).
57. Në lidhje me këtë dhe në pajtim me parimet e zhvilluara nga GJEDNJ, arsyetimi i vendimit të gjykatave për vazhdimin e paraburgimit në pritje të dënimit duhet të jetë gjithnjë evident, përkatësisht të jetë një arsyetim i detajuar dhe i bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit. Në këtë kontekst, GJEDNJ në mënyrë të vazhdueshme ka nënvizuar se “[...] *vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të ketë një kontroll publik të administrimit të drejtësisë*” (shih rastet e GJEDNJ-së, [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003, paragrafi 37, [Tase kundër Rumanisë](#), nr. 29761/02, Aktgjykim i 10 qershorit 2008, paragrafi 41, si dhe rastin e Gjykatës, KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 80).
58. Në dritën e kësaj që u thekua më lart, GJEDNJ po ashtu ka konstatuar se “*zgjatja pothuajse automatike e paraburgimit është në kundërshtim me garancitë e përcaktuara*” në nenin 5, paragrafin 3 të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, rastin e cituar më lart [Tase kundër Rumanisë](#), paragrafi 40). Prandaj, GJEDNJ ka vlerësuar se edhe nëse arsyet e lartcekura kanë ekzistuar në momentin e caktimit të paraburgimit, natyra e këtyre arsyeve apo rrethanave mund të ndryshojë me kalimin e kohës (shih rastin e cituar më lart të GJEDNJ-së, [Merabishvili kundër Gjeorgjisë](#), paragrafi 234 dhe rastin e Gjykatës, KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 81).
59. Gjykata dhe GJEDNJ po ashtu theksojnë se paragrafi 3 i nenit 5 të KEDNJ-së nuk mund të shihet se autorizon paraburgimin pa kushte me kusht që ai të mos zgjasë më shumë se një periudhë minimale e caktuar. Arsyetimi për çdo periudhë paraburgimi, sado i shkurtër qoftë, duhet të demonstron bindshëm nga autoritetet shtetërore (shih rastin e Gjykatës, KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 80 dhe rastet e GJEDNJ-së, [Idalov kundër Ruisë \[DhM\]](#), cituar më lart, paragrafi 140; [Castravet kundër Moldavisë](#), nr. 23393/05, Aktgjykim i 13 marsit 2007, paragrafi 33; [Belchev kundër Bullgarisë](#), nr. 39270/98, Aktgjykim i 8 prillit 2004, paragrafi 82).

(ii) Zbatimi i kritereve të GJEDNJ-së në lidhje me vazhdimin e paraburgimit në pritje të gjykimin në rastin e parashtruesit të kërkesës

60. Duke u bazuar në atë që u theksua më lart, vërej që caktimi i paraburgimit në fjalë, është i bazuar në pikën 2 të paragrafit 1 të nenit 29 të Kushtetutës në lidhje me pikën c të paragrafit 1 të nenin 5 të KEDNJ-së.
61. Në vijim, bazuar në shpjegimin e mësipërm të parimeve kryesore të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, unë do të shqyrtoj nëse parashtruesi i kërkesës ka dëshmuar dhe mbështetur mjaftueshëm pretendimet për shkeljen e garancive procedurale të përcaktuara në Kushtetutë dhe KEDNJ lidhur me vazhdimin e paraburgimit të tij.

62. Fillimisht, ritheksoj se paraburgimi i parashtruesit të kërkesës është i bazuar në pikën 2 të paragrafit 1 të nenit 29 të Kushtetutës dhe paragrafin 5 të KEDNJ-së, gjegjësisht paraburgimit në pritje të gjykimit.
63. Rikujtoj se parashtruesi i kërkesës pretendon që aktvendimi i kontestuar për vazhdimin e paraburgimit shkel nenin 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, dhe specifikisht Gjykata e Apelit në mënyrë arbitrare ka interpretuar dispozitat e KPPRK-së në lidhje me rreziqet procedurale të cilat shërbejnë si bazë për caktimin dhe vazhdimin e paraburgimit, si dhe lidhur me këtë nënvizon se gjykata: (a) thirret në dënimin potencial të lartë të parashtruesit nëse vërtetohet fajësia e tij në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë; (b) nuk ka arsyetuar lidhjet shoqërore dhe familjare të tij me Republikën e Serbisë në raport me arratisjen potenciale të tij si dhe hetimet nuk mund të pengohen sepse janë kryer para ngritjes së aktakuzës; (c) nuk ka marrë parasysh faktin se ai ka kaluar në paraburgim më shumë se 17 (shtatëmbëdhjetë) muaj që sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e zvogëlon rrezikun për arratisje; (c) në kontekst të ndikimit në dëshmitarë, parashtruesi pretendon se njohja me ta nuk përbën rrezik konkret sepse të njëjtit janë dëgjuar si dhe në të kundërtën do të duhej të ishin në raport varësie apo frike dhe se e njëjta vlen edhe për konstatimin e gjykatës se të pandehurit jetojnë në një qytet të vogël dhe se njihen mes veti; (e) parashtruesit të kërkesës i është sekuestruar një sasi e mjeteve financiare që tejkalon dyfishin e vlerës financiare të keqpërdorimit të pretenduar të detyrës zyrtare nga i pandehuri andaj nuk ka rrezik për arratisje; (f) nuk ka arsyetuar se pse masat më të buta janë më pak të përshtatshme sesa paraburgimi; si dhe (g) edhe përkundër sekuestrimit të një shume të konsiderueshme të të hollave (3,500,000 euro), parashtruesi i kërkesës është në gjendje të ofrojë garancinë shtesë (dorëzani) në formë të hipotekave apo pasurisë tjetër të përshtatshme, se nuk do t'i shmanget procedurës penale.
64. Prandaj, sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se vendimet që kanë të bëjnë me vazhdimin e paraburgimit të tij janë nxjerrë në kundërshtim me nenin 29 të Kushtetutës në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, unë fillimisht do t'i referohem periudhës së mbajtjes së parashtruesit të kërkesës në paraburgim në pritje të gjykimit, në kuptim të pikës 2 të paragrafit 1 të nenit 29 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 3 të nenit 5 të KEDNJ-së dhe kriteret e përcaktuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.
- (a) mbajtja e parashtruesit të kërkesës në paraburgim në pritje të gjykimit*
65. Në rastin konkret, rikujtoj se parashtruesi i kërkesës, pas arrestimit të tij, më 23 dhjetor 2021 është vendosur në paraburgim të paktën deri në momentin e parashtrimit të kërkesës në Gjykatë. Parashtruesit të kërkesës i është vazhduar paraburgimi gjatë periudhës ndërmjet 23 dhjetorit 2021 dhe 9 dhjetorit 2022 gjithsej 8 (tetë) herë, ndërsa nga ngritja e aktakuzës më 9 dhjetor 2022 deri më 7 qershor 2023, i është vazhduar paraburgimi edhe 3 (tri) herë.
66. Rikujtoj se kundër Aktvendimit [PKR. nr. 239/22], të 7 prillit 2023, të Gjykatës Themelore për vazhdimin e paraburgimit nga 8 prilli 2023 deri më 7 qershor 2023, parashtruesi kishte parashtruar ankesë. Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN1. nr. 422/2023], të 3 majit 2023, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi aktvendimin e Gjykatës Themelore.
67. Në lidhje me këtë, unë vërej se nga arrestimi i parashtruesit të kërkesës deri në ngritjen e aktakuzës, i njëjti ka qëndruar në paraburgim 11 (njëmbëdhjetë) muaj e 17 (shtatëmbëdhjetë) ditë, dhe më pas nga ngritja e aktakuzës deri në momentin e parashtrimit të kërkesës para Gjykatës gjithsej 5 (pesë) muaj e 30 (tridhjetë) ditë. Theksoj se parashtruesi i kërkesës ka qëndruar gjithsej 17 (shtatëmbëdhjetë) muaj e 10

(dhjetë) ditë në paraburgim, deri më 7 qershor 2023, kur edhe ka skaduar paraburgimi i caktuar sipas Aktvendimit të kontestuar, megjithatë, duke marrë parasysh se parashtruesi i kërkesës konteston para Gjykatës vazhdimin e paraburgimit përmes Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, të 3 majit 2023, Gjykata do të marrë parasysh vetëm periudhën kohore pas ngritjes së aktakuzës për vlerësimin e arsytimit të aktvendimit për vazhdim të paraburgimit në pritje të gjykimit, pra 5 (pesë) muaj e 30 (tridhjetë) ditë.

(b) *Vlerësimi në lidhje me arsytimin për vazhdim të paraburgimit në pritje të gjykimit*

68. Në rastin e parashtruesit të kërkesës, rikujtoj se Gjykata Themelore duke iu referuar nenit 184 të KPPRK-së konstatoi se përveç që ekziston dyshimi i bazuar për kryerjen e veprës penale, të cilën e mbështeti në një mori provash, po ashtu konstatoi se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit për arsyet si në vijim: (i) pesha e veprës penale, gjegjësisht, kanosja e dënimit të lartë në rast të provimit të fajësisë për gjithsej 28 (njëzet e tetë) vepra penale të cilat i ngarkohen parashtruesit të kërkesës; (ii) lidhjet e parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurve tjerë me shtetin e Serbisë përmes nënshtetësisë së dyfishtë, dhe lidhjeve familjare e shoqërore dhe faktin se Republika e Kosovës nuk ka bashkëpunim me këtë të fundit për sigurimin e prezencës së tyre në rast të arratisjes; (iii) tentimi i pengimit të procedurës penale gjatë fazës së hetimeve përmes frikësimit apo ndërhyrjes në dëshmitarë që ka rezultuar edhe me dy çështje tjera penale për veprat penale "*Pengimi i të provuarit të procedurës penale*" dhe "*Frikësimi gjatë procedurës penale*"; (iv) gjendja e arratisë së të pandehurve të tjerë të cilët njihen me parashtruesin e kërkesës dhe banojnë në një qytet relativisht të vogël, si dhe fakti që kanë punuar në një institucion dhe i njohin dëshmitarët dhe dëshmitarët bashkëpunues të cilët tashmë dihen pas ngritjes së aktakuzës; si dhe (v) masat e tjera alternative për sigurimin e prezencës së parashtruesit të kërkesës janë vlerësuar më pak të përshtatshme se paraburgimi. Ky arsyetim i Aktvendimit [PKR.nr.239/22], të 7 prillit 2023, të Gjykatës Themelore është vërtetuar edhe përmes Aktvendimit [PN1. nr. 422/2023], të 28 prillit 2023, të Gjykatës së Apelit.

69. Më tej, rikujtoj Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, në të cilin është dhënë arsyetimi kolektiv për parashtruesin e kërkesës dhe 6 (gjashtë) të pandehurit e tjerë si në vijim:

"[...] Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur të pandehurve i ka vazhduar masën e paraburgimit konform nenit 190 par 1 dhe 2 e lidhur me nenin 184 par. 1. nënpar. 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.1 të KPP-së, pasi që ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit janë kryes të këtyre veprave penale për të cilat në rast se vërtetohet fajësia e tyre janë paraparë dënime të larta me burgim, duke marrë parasysh lidhjet e tyre me shtetin e Serbisë përmes nënshtetësisë e me pas lidhjeve familjare dhe shoqërore, shton dyshimin e bazuar se te njëjtë mund te ikin apo largohen nga vendi ashtu që të jenë të pa arritshëm për organet e ndjekjes dhe me këtë do të pengonin zbatimin e hetimeve dhe vërtetimin e gjendjes faktike, andaj vazhdimi i masës së paraburgimit ndaj te pandehurve është e domosdoshme me qëllim të zhvillimit me sukses të kësaj procedure penale.

[...] duke marrë parasysh se gjatë hetimeve në rastin konkret janë bërë tentimet që të pengohet procedura penale dhe të ndikohet në dëshmitarë përmes frikësimit, apo ndërhyrjes, dhe për këtë janë filluar hetimet edhe ne dy çështje tjera penale ndaj personave të caktuar për veprat penale Pengimi i të provuarit të procedurës penale dhe Frikësimi gjatë procedurës penale, po ashtu disa të pandehur ende gjenden ne arrati, dhe duke pas parasysh faktin se te pandehurit njihen mes veti sepse banojnë ne një qytet relativisht te vogël dhe kane qenë të punësuar në të njëjtin vend dhe po ashtu njihen edhe me dëshmitarët dhe dëshmitaret bashkëpunues të këtij rasti, e që

paraqesin rrethana të veçanta që tregojnë rrezikun se me gjetjen në liri të të pandehurve apo me shqiptimin e ndonjë masë tjetër, do të ndikojnë në dëshmitarë apo do të mund të i fshehin provat mbi pasurinë e fituar me veprën penale dhe në këtë mënyrë do të pamundësojnë hetimin dhe zbardhjen e rastit gjer në fund.

Për arsyet e lartcekura, kjo Gjykatë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur të pandehurve të lartcekur i'u ka vazhduar masën e paraburgimit, ngase masat e tjera të parapara nga neni 171 të KPPK-së, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së tyre në procedurë. [...]"

70. Në lidhje me këtë, vërej se Gjykata e Apelit e konfirmoi arsyetimin e Gjykatës Themelore në lidhje me kriteret për vazhdimin e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës dhe 6 (gjashtë) të pandehurve tjerë si dhe përsëriti arsyet për përmbushjen e kritereve të tilla.
71. Në rastin konkret, unë fillimisht rikujtoj se KPPRK, i cili ka hyrë në fuqi më 17 shkurt 2023, përkatësisht paragrafi 1 i nenit 184, përcakton procedurën dhe kriteret ligjore për caktimin e masës së paraburgimit, përfshirë: 1) ekzistimin e “*dyshimit të bazuar*”; 2) përmbushjen e kushteve për vazhdimin e paraburgimit që duke marrë për bazë rrethanat e kryerjes së veprës penale ekziston rreziku që parashtruesi i kërkesës mund të përsërisë veprën penale; si dhe 3) masat më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit janë të pamjaftueshme për të siguruar praninë e personit të tillë, të parandalojnë përsëritjen e veprës penale dhe të sigurojnë zbatimin e suksesshëm të procedurës penale (shih, po ashtu, rastet e Gjykatës KI63/17, parashtrues *Lutfi Dervishi*, cituar më lart, paragrafi 68 dhe paragrafi 59; dhe KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 93).
72. Rikujtoj se Gjykata dhe GJEDNJ po ashtu kanë përcaktuar katër arsye themelore të rëndësishme për vazhdimin e paraburgimit të personave në pritje të gjykitimit, përkatësisht: 1) rrezikun e arratisjes; 2) ndërhyrjen në gjykatë; 3) parandalimin e krimit; 4) nevojën për të ruajtur rendin publik. Megjithatë, sipas saj dhe GJEDNJ-së, këto baza të paraburgimit duhet të shqyrtohen dhe shihen së bashku me mundësinë e shqyrtimit të masave tjera, të parapara me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.
73. Gjithashtu, theksoj argumentet e dhëna në aktvendimet e gjykatave të rregullta përkitazi me (i) rrezikun e arratisjes; (ii) ndërhyrjen në gjykatë, gjegjësisht pengimin e procedurës penale si dhe (iii) pamjaftueshmërinë e masave tjera alternative për sigurimin e prezencës së parashtruesit të kërkesës në raport me paraburgimin.
74. Në këtë kontekst, GJEDNJ nënvizon se rreziku që i akuzuari të pengojë zhvillimin e duhur të procedurës nuk mund të mbështetet “*in abstracto*”, ai duhet të mbështetet me prova faktike (*Becciev kundër Moldavisë*, nr. 9190/03, Aktgjykim i 4 tetorit 2005, paragrafi 59), ndërsa në rastin konkret në aspekt të pengimit/ndërhyrjes në procedurën penale, Gjykata rikujton faktin se janë iniciuar dy çështje për veprat penale “*Pengimi i të provuarit të procedurës penale*” dhe “*Frikësimi gjatë procedurës penale*”. Megjithatë, në lidhje me këtë, vërej se në këtë argument është mbështetur në aktvendimet e mëhershme të Gjykatës Themelore për caktimin dhe vazhdimin e paraburgimit, respektivisht, Aktvendimin e 10 dhjetorit 2022 dhe atë të 8 shkurtit 2023, të konfirmuara nga aktvendimet respektive të Gjykatës së Apelit.
75. Po ashtu rikujtoj se gjykatat e rregullta kanë dhënë arsyetim edhe për elementin e “*rrezikut për arratisje*” si vazhdimisht ekzistent, ku thirren në nënshtetësinë e dyfishtë të parashtruesit të kërkesës dhe pandehurve të tjerë, në lidhjet e tyre shoqërore dhe familjare me shtetin e Serbisë ku në rast të arratisjes do të ishte i pamundur sigurimi i prezencës së tyre për shkak të mungesës së bashkëpunimit ndërkombëtar në çështje

penale me të njëjtin shtet, i cili argument po ashtu është përsëritur në aktvendimet e mëhershme të Gjykatës Themelore për caktimin dhe vazhdimin e paraburgimit, respektivisht, në Aktvendimin e 10 dhjetorit 2022 dhe Aktvendimin e 8 shkurtit 2023, të konfirmuara nga aktvendimet respektive të Gjykatës së Apelit.

76. Bazuar në sa më sipër, arrij në përfundim se Gjykata Themelore në tri aktvendimet e saj të fundit (të 10 dhjetorit 2022; të 8 shkurtit 2023; dhe të 7 prillit 2023) pas ngritjes së aktakuzës, në vazhdimësi kishte dhënë arsytim pothuajse identik sa i përket rrezikut për arratisje dhe ndërhyrje në gjykatë.
77. Gjithashtu, ritheksoj konstatimin e gjykatave të rregullta në lidhje me pamjaftueshmërinë e masave tjera alternative për sigurimin e prezencës së parashtruesit të kërkesës në raport me paraburgimin, më saktësisht të Gjykatës së Apelit në Aktvendimin e kontestuar si në vijim: *“[...] masat e tjera të parapara nga neni 171 të KPPK-së, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së tyre në procedurë, në rrjedhën normale të procedurës penale dhe në parandalimin e kryerjes së veprave tjera penale, prandaj, me qëllim të zbatimit me sukses të procedurës penale, vazhdimi i masës së ndalimit për të i'u ofruar vendit ose personit të caktuar si dhe masës së paraqitjes në stacionin policor konsiderohet si e domosdoshme, kurse ankesat e mbrojtësve të pandehurve janë refuzuar si të pabazuara”*. Në këtë kuptim, Gjykata konsideron se ky konstatim është i përgjithësuar dhe jo i individualizuar, marrë parasysh se vlen për 7 (shtatë) të pandehurit, përfshirë parashtruesin e kërkesës, në këtë procedurë penale.
78. Për më tepër, përkitazi me vlerësimin e gjykatave të rregullta në lidhje me masat e tjera alternative, theksoj edhe vlerësimin e Gjykatës Supreme, e cila në Aktgjykimin [Pml. nr. 251/2023] e saj, të 30 majit 2023, aprovoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të bashkëpandehurit të parashtruesit të kërkesës, J.K., kundër Aktvendimit të kontestuar, duke e anuluar këtë të fundit, dhe kthyer çështjen në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, me arsytimin si në vijim:

“Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme të mbrojtësve të të pandehurit janë të bazuara, ngasë gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, nuk kanë dhënë arsytim për mos aplikimin e masave alternative, duke dhënë një arsytim shumë të përgjithësuar, stereotip dhe shabllon, kur kanë dhënë arsytimin në pjesën që ka të bëjë me mos aplikimin e masave të tjera alternative në lidhje me të pandehurin [J.K.]

Kjo, nisur edhe nga fakti se mbrojtja ka theksuar se familja e të pandehurit është e gatshme që të ofrojë si dorëzani pasurinë e paluajtshme në emër të të pandehurit [J.K.] ose në çfarëdo shume që parasheh gjykata. Paraburgimi është mase më e rëndë dhe masa e fundit e paraparë, për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurën penale, dhe si e tillë duhet të aplikohet vetëm kur masat e tjera alternative nuk mund të aplikohen. [...]”

79. Në këtë kontekst, unë theksoj se GJEDNJ ka gjetur shkelje të nenit 5 paragrafi 3 të KEDNJ-së në një numër të madh rastesh në të cilat gjykatat vendase kishin përdorur formulime stereotipe për vazhdimin e paraburgimit, pa marrë parasysh dhe pa argumentuar bindshëm nevojën e vazhdimin të paraburgimit mbi bazën e fakteve dhe rrethanave specifike të rastit (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Orban kundër Kroacisë](#), nr. 56111/12, Aktgjykim i 19 dhjetorit 2013, paragrafi 59; [Sulaoja kundër Estonisë](#), nr. 55939/00, Aktgjykim i 15 shkurtit 2005, paragrafi 64; [Tsarenko kundër Rusisë](#), nr. 5235/09, Aktgjykim i 3 marsit 2011, paragrafi 70, si dhe shih rastin e Gjykatës, KI10/18, parashtrues *Fahri Deqani*, cituar më lart, paragrafi 103).

80. Prandaj, vlerësoj se arsyetimi i Gjykatës Themelore, i konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të kontestuar është një arsyetim i përgjithësuar dhe jo mjaftueshëm i arsyetuar, ku qartësisht mungon një analizë dhe vlerësim i argumentuar dhe bindës i fakteve dhe rrethanave konkrete të rastit.
81. Për më tepër, gjykatat e rregullta dështuan të ofrojnë arsyetim konkret dhe të mjaftueshëm përse vazhdimi i paraburgimit në pritje të gjykimit ndaj parashtruesit të kërkesës ishte i domosdoshëm dhe përse masat alternative nuk ishin të aplikueshme në rastin e parashtruesit të kërkesës.
82. Prandaj, një arsyetim dhe elaborim i mirëfilltë i të gjitha rrethanave konkrete, përfshirë edhe arsyetimin e detajuar përse masat tjera alternative nuk mund të gjenin zbatim në rastin e parashtruesit të kërkesës do të ishin dëshmi e qartë e vlerësimit të individualizuar në përputhje me specifikat e rastit, si dhe arsye të qëndrueshme për nevojën e vendosjes sikurse me rastin e vendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta, lidhur me vazhdimin e paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës në pritje të gjykimit.
83. Andaj, edhe nëse arsyet për vazhdimin e paraburgimit vazhdojnë të jenë ende të pranishme, ritheksoj se këto arsye secilën herë kërkojnë një shqyrtim të vazhdueshëm dhe të individualizuar në përputhje me specifikat e rastit konkret, pasi që natyra e këtyre arsyeve apo rrethanave të cilat në fillim kanë justifikuar caktimin dhe/apo vazhdimin e paraburgimit mund të ndryshojnë me kalimin e kohës, gjë e cila nuk ka ndodhur në rastin e tanishëm para Gjykatës.
84. Në lidhje me këtë, rikujtoj praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e cila ka konstatuar se *“zgjatja pothuajse automatike e paraburgimit është në kundërshtim me garancitë e përcaktuara”* në paragrafin 3 të nenit 5 të KEDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Tase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 40) dhe vlerësoj se mungesa e arsyetimit konkret dhe të detajuar, si dhe vazhdimi i paraburgimit në pritje të gjykimit nga gjykatat e rregullta me arsyetimin e njëjtë nuk është në pajtim me parimet dhe standardet e vendosura nga GJENDJ-ja.
85. Rrjedhimisht, vlerësoj se vazhdimi i paraburgimit ndaj parashtruesit të kërkesës në pritje të gjykimit të tij, i konfirmuar me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit respektivisht, Aktvendimin [PN1. nr. 422/2023], të 28 prillit 2023, përbën shkelje të pikës (2) të paragrafit 1 të nenit 29 të Kushtetutës, në lidhje paragrafin 3 të nenit 5 të KEDNJ-së.

III. Përfundim në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtruesit të kërkesës

86. Bazuar në sa më sipër, dhe duke marrë parasysh edhe shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në kërkesën e tij:

- I. **KONSIDEROJ SE** Gjykata është dashur **TA DEKLAROJË** kërkesën të pranueshme;
- II. **KONSIDEROJ SE** Gjykata është dashur **TË KONSTATOJË** se Aktvendimi [Pn1. nr. 422/2023] i Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 28 prillit 2023, nuk është në pajtueshmëri me pikën 2 të paragrafit 1 të nenit 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 3 të nenit 5 (E drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. **KONSIDEROJ SE** Gjykata është dashur **TË DEKLAROJË** të pavlefshëm Aktvendimin e kontestuar [Pn1. nr. 422/2023] të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 28 prillit 2023.

Mendimi mospajtues është paraqitur nga gjyqtari;

Radomir Laban, gjyqtar



Më 27 mars 2024 në Prishtinë